



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 nr. 03-314

25.09.2023

SHkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 64, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencia për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2998/1 datë 31.7.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3506/5 datë 25.9.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 30-të mbajtur më 22.9.2023, miratoi si vijon:

#### **Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, për shkeljen e kryer të nenit 64, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), për mënyrën që në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, të transmetuar më 6 korrik 2023, në filmat vizatimorë "Tomi dhe Xheri " ( Tom and Jerry ) , pjesët në të cilat ka fjalë janë dhënë burimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase. Gjithashtu, në emisionin "Дневна соба"(Dhoma e ndenjes), deklarata e bashkëbiseduesit është transmetuar burimisht në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2998/1 datë 31.7.2023 e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

2. DETYROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit, përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

#### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit të cituar, lejejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmer masë-aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të tij, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 64 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit janë të detyruar të transmetojnë programin në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, dhe në rastet kur programi i dedikohet komunitet(bashkësisë) që nuk është shumicë, në gjuhën dhe shkrimin e atij komuniteti.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 31 korrik 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, transmetuar më 6 korrik 2023, në nivel rajonal, në të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Gjegjësisht, nga mbikëqyrja e rregullt është konstatuar se më 6 korrik 2023, në shërbimin programor televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, në filmat vizatimorë "Tomi dhe Xheri" (Tom and Jerry), pjesët në të cilat ka fjalë janë dhënë burimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase. Po ashtu, në emisionin "Дневна соба"(Dhoma e ndenjes), deklarata e bashkëbiseduesit është transmetuar burimisht (fillimisht) në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2998/1 datë 31.7.2023 e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, më 1.8.2023, i dërgoi Shkresë ark.nr. 10-2998/2 datë 1.8. 2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10- 2998/1 nga 31.7 2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa ishte pranuar në mënyrë të rregullt më 22.8. 2023. Në afatin e parashikuar, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë nuk u deklarua për shkeljen e kryer të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 22.9.2023, shqyrtoi Raportin me shkrim dhe konstatoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, t'i shqiptoi masë - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 64, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndëmarrrjen e masës (Teksti i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2998/1 datë 31.7.2023 dhe Konkluzionin ark.nr 02-3506/5 datë 25.9.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën mbajtur me 22.9. 2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë dhe urdhërohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

#### **Shtojca (1):**

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2998/1 datë 31.7.2023.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.